



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**



**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**  
**Telecommunications Regulatory Authority**  
**Regulativni Autoritet Telekomunikacije**

**Nr. Prot. 018/B/12**

**VENDIMI Nr. ...**

**Për**  
**Përcaktimin e ndërmarrjes PTK sh.a**  
**si**  
**'Ofrues me Fuqi të Ndjeshme në Tregun e Qasjes në rrjetin publik telefonik në lokacion fiks'**

Në mbështetje të neneve 1.1, 1.2, 6, 11.7 dhe 44 të Ligjit të Telekomunikacionin Nr. 2002/7, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-085 (tutje referuar si - Ligji); neneve 3.10, 5 dhe 6 të Rregullores për Analizat e Tregut dhe Përcaktimin e Ofruesve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT), Nr. Prot. 115/1/10 (tutje referuar si - Rregullorja për Analiza të tregut); Rregulloren për Sigurimin e Qasjes, Nr. Prot. 012/B/11 (tutje referuar si - Rregullorja e Qasjes); Rregulloren për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e Operatorit, Nr. Prot. 47/1/10, (tutje referuar si - Rregullorja për CS/CPS); pikës 3.8.3 i Dokumentit mbi Politikën e Sektorit të Telekomunikacionit, Nr. 02/255 datë; 13 Qershor 2007; Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE); Direktivës 2002/21/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës; 7 Mars 2002 për Rrjetat dhe Shërbimet e Komunikimeve Elektronike (Direktiva Kornizë), Rekomandimit të Komisionit Evropian (2003/311/EC), e ndryshuar me Direktivën 2009/140/EC, së bashku me rekomandimin (2007/879/EC) e pasuar me atë të datës; 17 Dhjetor 2007 mbi produktet dhe shërbimet relevante të tregjeve të ndjeshme me rregullimin *ex-ante*; Udhërrëfyesin e Komisionit Evropian mbi analizën e tregjeve dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg sipas kornizës rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2002/C 165/03); Vendimit Nr. 58 për Analizën e tregjeve të telefonisë fikse të datës; 31 Janar 2011, Nr. Prot. 002/B/11, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 128 të datës; 13 Shtator 2011, Nr. Prot. 051/B/11; Raportit mbi Analizën e Tregut të Telefonisë Fikse dhe përcaktimin e operatorit me fuqi të ndjeshme në treg (tutje referuar si - Raporti); në përputhje me dispozitat e neneve 20 dhe 22 të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (Nr. Prot. 161/06), Bordi i ART i përbërë nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha Kryetar i Bordit
- 2) z. Besnik Berisha, Anëtar i Bordit
- 3) z. Lulzim Kurtaj Anëtar i Bordit
- 4) z. Nijazi Ademaj, Anëtar i Bordit

në mbledhjen e XXXII të Bordit të mbajtur me datë; 22 Shkurt 2012, bazuar në shqyrtimin e materialeve për analizat e tregut të telefonisë fikse dhe përcaktimin e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), të përgatitur nga Grupi Punues për Analizë të Tregut (GP) në bashkëpunim me ekspertët nga TAIEK, pas përfundimit të këshillimit publik, vendosi si më poshtë,

## V E N D I M

I. PTK sh.a përcaktohet të ketë fuqi të ndjeshme në tregun e 'Qasjes në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse'.

II. PTK sh.a. e përcaktuar si Ofrues me Fuqi të Ndjeshme në Treg detyrohet të zbatoj obligimet e përcaktuara në bazë të Ligjit dhe Rregullores për Analiza të tregut, neni 6, si në vijim;

- 1) Obligimi i Qasjes
- 2) Obligimi për mos-diskriminim
- 3) Obligimi i Transparencës
- 4) Obligimi për Kontrollin e Çmimeve
- 5) Obligimi për ndarjen e llogarive
- 6) Obligimi për mos subvencionimin e tërthortë

III. Obligimet e përcaktuar në pikën II të këtij vendimi përfshijnë:

1. **Obligimi i Qasjes** sipas nenit 57 të Ligjit dhe nenit 6.4 të Rregullores për Analiza të Tregut. Ndërmarrja PTK sh.a. për përdoruesit e saj fundor duhet të siguroj falas;

1.1. qasje në shërbimet publike të telefonisë për cilindo ofrues të shërbimeve publike të telefonisë në përputhje me kushtet dhe procedurat, e miratuara nga ART në Rregulloren për CS/CPS;

1.2. mundësinë për të marrë një faturë të vetme në rast se ai përdorë para zgjedhjen e bartësit për të gjitha thirrjet dalëse. Ky obligim përfshinë kërkesën që PTK sh.a. të ofroj produkt-e shoqëruese në nivel me shumicë - p.sh. Linja me qira me shumicë (WLR - siç përcaktohet në Kapitullin II të Raportit për analiza të tregut) sipas kushteve të specifikuara në Rregulloren e Qasjes, duke i lejuar ofruesit tjetër të shërbimeve publike të telefonisë, që përdorin ofertën e para-zgjedhjes për të gjitha thirrjet, që të lëshojnë një faturë të vetme për përdoruesin (duke përfshirë si tarifën për shfrytëzimin e qasjes fikse të PTK-së ashtu edhe tarifën për shërbimin e përdorur publik të telefonisë). Derisa PTK sh.a. ofron WLR, ajo duhet të;

- a) plotësoj kërkesat e arsyeshme të operatorëve tjerë për ofrim të WLR;
- b) negocioj në mirëbesim me ndërmarrjet që kërkojnë qasje në WLR;
- c) të mos e tërheqë qasjen tashmë të dhënë për objekte/fasilitete;
- d) ofroj qasje të hapur në ndërlidhësit/interfejsët teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera kyçe që janë të pazëvendësueshme për ndërveprimin e shërbimeve ose shërbimeve virtuale të rrjetit;
- e) ofroj shërbime të veçanta të nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit për përdoruesit;
- f) ofroj qasje në sistemet operacionale mbështetëse ose sistemet tjera softuerike të ngjashme, të nevojshme për të siguruar konkurrencë të drejtë në ofrimin e shërbimeve;
- g) të interkonektoj rrjetet ose pajisjet e rrjetit, duke përfshirë mundësinë e interkonektimit të rrjeteve në çdo pikë të rrjetit kur kjo është teknikisht e mundur;
- h) mund të refuzoj të ofroj, të suspendoj ose të ndërpresë qasjen vetëm në rast se veprimet e tilla bazohen në kritere objektive, duke përfshirë jo-fizibilitetin teknik ose nevojën për të siguruar integritetin e rrjetit.

2. **Obligimi për mos-diskriminim** sipas neneve 24.3, 53.2 dhe 57.2 të Ligjit dhe nenit 6.6 të Rregullores për analiza të tregut. PTK sh.a. nuk duhet t'i diskriminoj përfituesit e qasjes fikse dhe WLR ndaj përfituesve tjerë dhe në veçanti, të aplikoj kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ndërmarrjet tjera që ofrojnë shërbime ekuivalente, dhe t'u ofroj shërbime dhe informata të tjerëve nën kushte të njëjta dhe të së njëjtës cilësi që ajo ofron për shërbimet e saj ose ato të njësive apo filialeve të saj. Ky obligim nuk pengon ofrimin e mundësive tjera të shërbimeve të qasjes fikse të dizajnuara për kategori të ndryshme të përdoruesve fundor, por PTK sh.a. duhet të aplikoj të njëjtat kushte për të njëjtën kategori të përdoruesve fundor (këto kategori nuk duhet të definohen shumë ngushtë me qëllim të veprimit në dëm të konkurrencës).
3. **Obligimi i Transparencës** sipas neneve 24.3.b, 57.1, 69.1 të Ligjit, dhe nenit 6.5 të Rregullores për analizat e tregut. PTK sh.a. duhet të siguroj se të gjitha kushtet për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse janë publikisht në dispozicion dhe se përdoruesi është i informuar për këto kushte para nënshkrimit të kontratës. Për më tepër PTK sh.a. duhet të i siguroj ART-së kontratën standarde për ofrimin e qasjes fikse (përfshirë edhe ato shërbime ku qasja fikse shitet si pako) së bashku me rregullat për ofrimin e shërbimeve brenda afatit kohor prej 10 ditë pune nga data e aprovimit të tyre. PTK sh.a. duhet, sa i përket produkteve të WLR, brenda afatit kohor prej 3 muajve nga data e aprovimit të këtij vendimi të publikoj ofertën referuese për produktet e WLR në përputhshmëri me kërkesat mbi informatat siç është përshkruar me Rregulloren e Qasjes, përfshirë informatat mbi llogaritë, specifikimet teknike dhe karakteristikat e rrjetit, kushtet e përdorimit, koston e shërbimeve të ndërlidhura të WLR;
4. **Obligimi për kontrollin e çmimeve dhe llogaritjen e koston** sipas nenit 24 të Ligjit dhe nenit 6.1, të Rregullores për analizat e tregut. PTK sh.a. sa i përket ofrimin të qasjes fikse dhe WLR duhet të siguroj që:
  - 4.1. Qasja fikse dhe çmimet e WLR janë të orientuara në kosto duke përdorur metodën e shpërndarjes së plotë të koston (ang. Fully Distributed Costs, tutje referuar si - FDC) dhe t'i ofroj ART-së të gjitha dokumentet e nevojshme për të dëshmuar këtë. Ky obligim hyn në fuqi pas miratimit të rregullores përkatëse për llogaritjen e koston sipas modelit FDC. Data e fillimit të implementimit të këtij obligimi do të përcaktohet me një vendim të veçantë të Bordit të ART-së. Derisa PTK sh.a. vërteton pranë ART-së se çmimet e qasjes fikse dhe të WLR janë të orientuara në kosto, siç është cekur më lartë, PTK sh.a. duhet të siguroj se çmimet e qasjes fikse dhe WLR nuk janë më të larta se çmimet e qasjes fikse që janë aplikuar nga PTK sh.a. më datë; 01 janar 2012.
  - 4.2 Të vendos sistemin e llogaritjes së koston në përputhje me parimet e përcaktuara me Rregulloren përkatëse, për të llogaritur koston FDC-së të qasjes fikse dhe produkteve WLR. Ky obligim hyn në fuqi pas miratimit të rregullores përkatëse për llogaritjen e koston sipas modelit FDC. PTK sh.a. duhet t'i ofroj ART-së të gjithë dokumentacionin përkatës, që vërteton se PTK sh.a. ka implementuar detyrimin e llogaritjes së koston së bashku me rezultatet (koston e shërbimit) brenda afatit kohor që do të përcaktohet nga ART. ART mund të miratoj rregulla të veçanta mbi llogaritjen e koston, të cilat pastaj do të zëvendësojnë kushtet e përcaktuara në Rregulloren për llogaritjen e koston.
  - 4.3 Në përputhje me Rregulloren për llogaritjen e koston, kërkesa për të vërtetuar se çmimet e rregulluara të PTK sh.a. janë të bazuara në kosto bie mbi PTK-në. Nëse ART nuk është e bindur se llogaritja e koston është zbatuar në përputhje me kërkesat e

vendosura nga ART dhe (ose) çmimet e rregulluara nuk janë të bazuara në kosto, ART mund t'i kërkoj operatorit PTK sh.a. për të ndryshuar këto çmime, ose për të vendosur ato duke përdorur mënyra të tjera (p.sh. modelet 'bottom-up', 'benchmarking', 'retail minus', etj);

4.4 Të mos ofroj në pako shërbimet e qasjes fikse me shërbime të tjera të panevojshme. Ky obligim nuk pengon ofrimin e shërbimeve në pako si mundësi për përdoruesit fundor, por ofrimi i pakove të tilla nuk duhet të veproj në dëm të konkurrencës. Prandaj çmimet e qasjes fikse duhet:

- mjaftueshëm të jenë të ndara në mënyrë që t'u mundësoj përdoruesve të mos paguajnë shërbimet, të cilat nuk i shfrytëzojnë;
- të jenë transparente, jo-diskriminuese dhe të pandikuara nga aplikimi i përdoruesve;
- të jenë publikisht në dispozicion dhe të publikuara në faqen e internetit të ofruesit;
- të jenë të dizajnuara në atë mënyrë që zbritjet të përshtaten në mënyrë që shërbimet e lidhura ose produktet nuk kanë efekt negativ në konkurrencë;

5. **Obligimi për ndarjen e llogarive** sipas nenit 45.3 të Ligjit dhe nenit 6.3 të Rregullores për analizat e tregut. Sa i përket WLR, PTK sh.a. duhet të ndajë të dhënat e saj kontable në mënyrë të tillë që ata do të ofrojnë informacion mjaft të detajuar (transferet e brendshme) për të dëshmuar ofrimin jo-diskriminues të produkteve WLR për operatorët tjerë kundrejt shitjes në nivel me pakicë të krahut të saj dhe për të parë ecurinë e ofrimit të produktit WLR sikur të ishte i ofruar nga entitete të veçanta. PTK sh.a., gjatë ndarjes së llogarive duhet të respektoj parimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostos të specifikuara në rregulloret për llogaritjen e kostos dhe ndarjes së llogarive. Ky obligim hyn në fuqi pas miratimit të rregulloreve në fjalë. PTK sh.a. duhet t'i ofroj ART-së të gjithë dokumentacionin përkatës, që vërteton se PTK sh.a. ka zbatuar detyrimin e ndarjes së llogarive së bashku me rezultatet (ndarjen e llogarive për tregjet e rregulluara) brenda afatit kohor që do të përcaktohet nga ART. ART mund të miratoj rregulla të veçanta për ndarje të llogarive, të cilat pastaj do të zëvendësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren për ndarje të llogarive.

6. **Obligimi për mos subvencionim të tërthortë** sipas nenit 45.2 të Ligjit dhe nenit 6.2 të Rregullores për Analizat e Tregut.

IV. Këtij vendimi i bashkëngjitet Raporti për "Analizat e tregut të Telefonisë Fikse dhe përcaktimin e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT)"

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Tregu i qasjes në rrjetet publike telefonike në lokacion fiks në Raport është definuar për ndërmarrjet PTK sh.a dhe IPKO Telecommunications LLC.

Analiza e tregut ka treguar se konkurrenca në tregun përkatës nuk është efektive duke u bazuar në faktet si në vijim;

- PTK sh.a ka pjesëmarrje 94,03% të tregut sa i përket numrit të përdoruesve që kanë qasje në rrjetet publike telefonike në lokacione fikse dhe ka pjesëmarrje mbi 90% të tregut nga të hyrat e gjeneruara dhe konkluzionet shtesë që argumentohen në raport si në vijim:
  - PTK sh.a posedon infrastrukturë e cila nuk është lehtësisht e duplikueshme;
  - PTK sh.a si operator vertikalisht i integruar ka përparësi të krijuara nga përmasat e rrjetit në nivel me shumicë dhe nga prezenca e përdoruesve të linjave të qasjes në tërë territorin e Republikës së Kosovës (*nivel me pakicë*), në krahasim me operatorin alternativ dhe operatorët e tjerë potencial në treg;
  - PTK sh.a është operatori më i madh i rrjetit të telefonisë fikse dhe po-ashtu është horizontalisht i integruar. PTK sh.a. ka përparësitë e aktiviteteve të ekonomisë së shkallës për rrjetin e qasjes si dhe ka përparësi të konsiderueshme në ekonominë e shkallës krahasuar me operatorët alternativ dhe atyre potencial;

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike;**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

#### **Vërtetim:**

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

**Prishtinë, 29/02/2012**

**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**

**Ekrem Hoxha  
Kryetar i Bordit**

Besnik Berisha, Anëtar i Bordit  
Lulzim Kurtaj, Anëtar i Bordit  
Nijazi Ademaj, Anëtar i Bordit

#### **Aktivendimi i dërgohet:**

- Operatorëve të Licencuar të Telefonisë Fikse,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Arkivit të ART-së